



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO



**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMI
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**

PROCUREMENT REVIEW BODY

192 / 20

29.04.20

PRIRODNE I PRIMJENJENE

PSH.nr.192/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068 dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi -Referues, z. Goran Milenković- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "Afrim A Beka B.I. & Alkoimpex-general construction Sh.p.k."-Prishtinë (në ankesë OE "Bashkimi Meti sh.p.k"- Prishtinë), kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve rurale LOT II" me nr. të prokurimit: 616-19-7786-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal-Prishtinë, më datën 28.04.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHEȚ, si e pa bazuar ankesa e operatorit ekonomik: ekonomik OE "Afrim A Beka B.I. & Alkoimpex-general construction Sh.p.k."-Prishtinë (OE "Bashkimi Meti sh.p.k"- Prishtinë), lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve rurale LOT II" me nr. të prokurimit: 616-19-7786-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal-Prishtinë.

II. VËRTETOHEȚ, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve rurale LOT II" me nr. të prokurimit: 616-19-7786-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal-Prishtinë.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues refuzohet si e pa bazuar, i bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE "Afrim A Beka B.I. & Alkoimpex-general construction Sh.p.k." (në ankesë OE "Bashkimi Meti sh.p.k"- Prishtinë) si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 20.03.2020 me nr. 192/20, kundër njoftimit për dhënien e kontrates lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve rurale LOT II" me nr. të prokurimit: 616-19-7786-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal-Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1,7,61,59,72 dhe 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Organi Shqyrtares i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 02.03.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtares të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtares i prokurimit në raportin e dt: 03.04.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 7, 59, 61, 72dhe 108 A të LPP-së, me arsyetimin se:

Autoriteti Kontraktues me dt.11.03.2020 na njofton me refuzimin e kërkesës për rishqyrtim lidhur aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve rurale LLOT 2 nr. i aktivitetit të prokurimit: 616-19-7786-2-1 -l

Ne si OE i pa kënaqur me njoftimin mbi dhënien e kontratës dhe eliminimin tonë ka ky aktivitetit të prokurimit të lartcekur me dt. 09.03.2020 kemi deponuar kërkesë për rishqyrtim me pretendim se AK gjatë fazës së vlerësimit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP dhe nuk qëndrojnë arsyet e eliminimit tonë nga ky aktivitet i prokurimit. PO ju njoftojmë si më poshtë me kërkesën për ri-shqyrtim dhe pretendimet tona ankimore:

Pas njoftimit për kontratë ne kemi shkarkuar DT dhe kemi plotësuar të gjitha kriteret dhe me datë : 12.02.2020 nga ana e AK është kërkuar sqarim lidhur me çmimin jo normalisht të ulët, ne për hirë të korrektesisë kemi dërguar sqarime por me një lëshim të vogël në faturë të cilin jemi munduar ta sqarojmë por sa për korrektesi ne po ua ri orientojmë është e rregullave për çmimin jo normalisht të ulët. Ku sipas rregullores thuhet:

3.1 Autoritet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

1. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm
2. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët
3. janë dorëzuar të paktën 3(tre) tenderë.

Pra, në këtë rast janë 8 (tetë) oferta dhe duhet llogaritur si vijon: 1) 55,405.13 €, 2) 89,742.20€, 3) 87,829.70 €, 4) 88,033.61 €, 5) 85,291.61 €, 6) 71,312.18€, 7) 82, 754.59€, 8) 59,017.12 €, totali 619,386.14 €. Pra, duhet të nxjerrët mesatarja pastaj të nxjerrët 30% dhe nëse del më lirë atëherë oferta kalon kushtin e parë, por ju keni bërë gabim në llogaritje për arsyet si vijon.

Mesatarja e ofertave është $619,386.14 \text{ €} / 8 = 77,423.27 \text{ €}$, kjo vlerë zbritet 30%, del vlera $23,226.98 \text{ €}$ dhe oferta jonë përmban çmim dy herë më të lartë se kjo vlerë. Gabimi që ka ndodhur nga ana e kompanisë furnizuese dhe nga ana jonë është një gabim që nuk ka ndryshuar në masë substanciale vlerën e ofertës dhe nuk është arsy për eliminim.

Andaj ne nuk e kuptojmë qëllimin tuaj ose gabimin e bërë në këtë vlerësim por kërkojmë që të aproponi kërkesën tonë dhe lëndën ta ktheni në ri-vlerësim. Edhe për kundër këtyre shpjegimeve AK nuk ka marr parasysh kërkesën tonë dhe me dt.11.03.2020 na njofton me vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim me arsyimet se: pasi që mesatarja e tenderëve të pranuar sipas këtyre rregullave pjesëtohet me pragu 30%, respektivisht me 1/3 dhe në këtë rast është 77,423.27 euro/l.3 është 59,556.36 euro e jo si që keni pretenduar ju në kërkesën tuaj 23,226.98 euro, dhe se fatura e dorëzuar nuk ka çmimin për njësi që duhet të hasur me çmimin e tenderit tuaj. Me këto veprime AK ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së dhe vërtetim i gabuar i gjendjes faktike.

Autoriteti kontraktues ka qenë i detyruar të veproj në pajtim me dispozitat e nenit 61 për çmimet jo-normalisht i ulët sepse AK nuk ka marr parasysh shpjegimet për të cilat ne kemi shtjelluar në kërkesën për ri-shqyrtim duke u bazuar në Rregullat për tenderët jo normalisht të ulët. Po ashtu ne kemi shpjeguar se fatura e dorëzuar nga furnizuesi është një gabim i lëshuar nga furnizuesi i cili nuk ka dhënë çmimin për njësi por kjo është lehtësisht e kuptueshme nëse kemi sasinë dhe totalin e këtij pozicioni gjejmë edhe çmimin për njësi sepse ne kemi një ofertë me çmim më të ulët dhe kriter i DT dhe NJPK ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët ë ne kemi plotësuar këtë kriter,

Ne nuk mund të kuptojmë se si ka mundësi që në kontratën që kemi me AK për "Mirëmbajtjen emergjente e rrugëve rurale llot II" me nr. të prokurimit 616 19 205 215 me çmime identike dhe nuk kemi asnjë problem në implementim dhe ne kemi sqaruar po ashtu AK se edhe këtë aktivitet të prokurimit do të implementojm në tërsi sikur atë të mirëmbajtjes emergjente, konsiderojmë se kemi të bëjmë me vlerësim jo real dhe jo të drejt në këtë rast.

Ne po ashtu qëndrojmë në tërësi pranë ofertës sonë dhe nëse AK ka dyshime se nuk mund të implementojm këtë kontratë kërkojmë që të ngitet sigurimi i ekzekutimit ashtu siç e parasheh vetë autoriteti kontraktues. AK ka qenë i detyruar që të merr parasysh sqarimet tona të dt.13.03.2020 sepse ne kemi dorëzuar edhe faturën e furnizuesit.

Neni 61 i LPP e rregullon çështjen e çmimeve jo-normalisht të ulet sepse e paragrafi 2 i këtij nenit e udhëzon AK që do të merr parasysh shpjegimet e dorëzuara nga tenderuesi.

1. Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni.
 2. Gjatë përcaktimit nëse një tender është apo duket të jetë jo-normalisht i ulet, autoriteti kontraktues do të merr parasysh shpjegimet e dorëzuara nga tenderuesi në lidhje me:
 - 2.1. ekonominë e procesit të prodhimtarisë, te shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;
 - 2.2. çfarëdo zgjidhje teknike që janë Ofruar ose zgjedhur;
 - 2.3. çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose
 - 2.4. origjinalitetin, e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

Po ashtu AK nuk ka marr parasysh dispozitat e nenit 72 të LPP sepse pikërisht kjo dispozitë e obligon AK që në rastet e tillë ku vërehet qartë se kemi të bëjmë me një Ofertë me çmim më të ulët të kërkoj sqarime dhe ti vlerësoj drejt se a është një gabim teknik dhe ky gabim a mund të korrigohet apo kemi të bëjmë me një gabim të qëllimshëm nga ana e tenderuesi për të vënë në lajthitje AK.”.

Duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit te lended eksperti shqyrtues konstaton se pretendimet e larte cekura të operatorit ekonomik ankues nuk janë të bazuara sepse AK me rastin e rivlerësimit të ofertave konform nenit 72 të LPP-së, ka kërkuar sqarime shtesë nga grupi i OE ankuese me datën 12.02.2020, përmes “letrës standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët”, ndërsa grupi i OE ankuese me datën 13.02.2020 ka dorëzuar shkresën sqaruese së bashku me Faturën nr.03/20 te datës 13.02.2020 të lëshuar nga “Lunari Company shpk” për “Bashkimi Meti shpk” në cilin figuron “Furnizimi dhe transporti me rërë” me “çmim njësi prej 1 euro” si dhe Pro faturën nr.21/20 te dates 13.02.2020 të lëshuar nga “Besimi Commerce shpk” për “Bashkimi Meti shpk” në cilin figuron “Kripe deti industriale (Refuz)” me “çmim njësi me tvsh prej 49 euro dhe në bazë të faturës në të cilën ka figuruar çmimi prej 1 euro për rërë dhe konform rekomandimeve të dala nga Vendimi i OSHP-së, PSH903/19 dt.05.02.2020, AK ka zbatuar nenin 3.1 të “Rregullave për tenderët Jo-normalisht të Ulët”, në bazë të të cilave konstatohet se oferta e grupit të OE ankuese për LOT 2, i plotëson të gjitha kushtet e mëposhtme:

- çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;
- çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;
- janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

Po ashtu eksperti shqyrtues konstaton se fakti i lartcekur, se oferta e grupit të OE ankuese për LOT 2 është e papërgjegjshme dhe se i plotëson të gjitha kushtet e parapara me nenin 3.1 të “Rregullave për tenderët Jonormalisht të Ulët” është konstatuar edhe me Vendimin e OSHP-së, PSH903/19 dt.05.02.2020, (shiko faqen 14 te këtij vendimi) si vijon:

tabelen nr.2)

Nr.	Lot 2- Tenderuesi 1: VAAKAL NNSH		
1	kompania 1 - eshte permibushur kushti i pare sepse janë pranuar 8 oferta	Pranuar 8 oferta	
2	1 AFRIM BEKA B I& ALKO IMPEX	55.405.13	
3	2 ZUKA COMMERCE	89.742.20	
4	3 TOIFOR SHPK	87.829.70	
5	4 INTEGRAL SHPK	88.033.61	
6	5 MILENIM		
7	KONSTRUKSION&ANUAR SHPK	85.291.61	
8	6 DARDANIA NPN	71.312.18	
9	7 V.Z COMPANY SHPK	82.754.59	
10	8 VAAKAL NNSH	59.017.12	
11	kompania 9 - eshte permibushur kushti i pare sepse janë pranuar 8 oferta	619.386.14	
12	kompania 10 - të gjitha ofertat janë kete çmimi permibushin kushtin e dyte	77.423.26	ne kete rast oferta B1 dhe B8 permibush kushtin e dyte prandaj vazhdohet me kushtin e trete
13	kompania 11 - pragu 10% ne mes ofertes me te lire ne krasim me oferten e dyte me te lire	ofertat 30% e ofertave e dyte	ne kete rast oferta B1,dhe B8 permibush edhe kushtin e trete

Kontrolli	Kritikesa	Arogjimi
1	Janë pranuar me shume se 3 oferta	Eshte plotësuar kushti i pare sepse janë pranuar 8 oferta
2	Çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshem	Oferta e 8 plotëson kushtin e dyte (30%) sepse çmimi i ofruar është me shume se 30% më i ulët se mesatarja e tendereve. Shih pragun ne kolonën C12
3	Çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët	Oferta e dyte plotëson edhe kushtin e trete (10%) sepse ne krasim me oferten e dyte me radje është me shume se 10% më i ulët. Shih pragun C13
Korrektive		Qytetarit që ka ofertën e 8 po përgjegjshëm e kushtin e dyte sepse janë pranuar 8 oferta

Andaj bazuar në faktet e lartë cekura AK më të drejtë e ka eliminuar grupin e OE ankuese nga ky aktivitet i prokurimit lidhur me LOT 2.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues të hujhet poshtë si e pa bazuar, dhe rekomandon qe të mbetet ne fuqi njoftimi për dhënie të kontratës i AK-së.

Autoriteti Kontraktues, me datë 03.04.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë 06.04.2020 ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues..

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 28.04.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Afrim A Beka B.I. & Alkoimpex-general construction Sh.p.k."- Prishtinë, se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 7, 59, 61, 72dhe 108 A të LPP-së, me arsyetimin se: "Autoriteti Kontraktues me dt.11.03.2020 na njofton me refuzimin e kërkesës për rishqyrtim lidhur aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve rurale LLOT 2" nr. i aktivitetit të prokurimit: 616-19-7786-2-1 –I. Ne si OE i pa kënaqur me njoftimin mbi dhëni e kontratës dhe eliminimin tonë ka ky aktivitetit të prokurimit të lartcekur me dt. 09.03.2020 kemi deponuar kërkesë për rishqyrtim me pretendim se AK gjatë fazës së vlerësimit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP dhe nuk qëndrojnë arsyet e eliminimit tonë nga ky aktivitet i prokurimit. Po ju njoftojmë si më poshtë me kërkesën për ri-shqyrtim dhe pretendimet tona ankimore: pas njoftimit për kontratë ne kemi shkarkuar DT dhe kemi plotësuar të gjitha kriteret dhe me datë: 12.02.2020 nga ana e AK është kërkuar sqarim lidhur me çmimin jo normalisht të ulët, ne për hirë të korrekësisë kemi dërguar sqarime por me një lëshim të vogël në faturë të cilin jemi munduar ta sqarojmë por për korrekësi ne po ua ri orientojmë është e rregullave për çmimin jo normalisht të ulët. Ku sipas rregullores thuhet:

3.1 Autoritet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

1. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm
2. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët
3. janë dorëzuar të paktën 3(tre) tenderë.

Pra, në këtë rast janë 8 (tetë) oferta dhe duhet llogaritur si vijon: 1) 55,405.13 €, 2) 89,742.20€, 3) 87,829.70 €, 4) 88,033.61 €, 5) 85,291.61 €, 6) 71,312.18€, 7) 82, 754.59€, 8) 59,017.12 €, totali 619,386.14 €. Pra, duhet të nxjerrët mesatarja pastaj të nxjerrët 30% dhe nëse del më lirë atëherë oferta kalon kushtin e parë, por ju keni bërë gabim në llogaritje për arsyet si vijon.

Mesatarja e ofertave është $619,386.14 \text{ €} / 8 = 77,423.27 \text{ €}$, kjo vlerë zbritet 30%, del vlera $23,226.98 \text{ €}$ dhe oferta jonë përmban çmim dy herë më të lartë se kjo vlerë. Gabimi që ka ndodhur nga ana e kompanisë furnizuese dhe nga ana jonë është një gabim që nuk ka ndryshuar në masë substanciale vlerën e ofertës dhe nuk është arsyе për eliminim.

Andaj, ne nuk e kuptojmë qëllimin tuaj ose gabimin e bërë në këtë vlerësim por kërkojmë që të aprovoni kërkësen tonë dhe lëndën ta ktheni në ri-vlerësim. Edhe për kundër këtyre shpjegimeve AK nuk ka marr parasysh kërkësen tonë dhe me dt.11.03.2020 na njofton me vendimin për refuzim të kërkësës për rishqyrtim me arsyetimet se: pasi që mesatarja e tenderëve të pranuar sipas këtyre rregullave pjesëtohet me pragun 30%, respektivisht me 1/3 dhe në këtë rast është 77,423.27 euro/1.3 është 59,556.36 euro e jo siç keni pretenduar ju në kërkësen tuaj 23,226.98 euro, dhe se fatura e dorëzuar nuk ka çmimin për njësi që duhet të hasur me çmimin e tenderit tuaj. Me këto veprime AK ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së dhe vërtetim i gabuar i gjendjes faktike. Autoriteti kontraktues ka qenë i detyruar të veproj në pajtim me dispozitat e nenit 61 për çmimet jo-normalisht i ulët sepse AK nuk ka marr parasysh shpjegimet për të cilat ne kemi shtjelluar në kërkësen për ri-shqyrtim duke u bazuar në Rregullat për tenderët jo normalisht të ulët. Po ashtu ne kemi shpjeguar se fatura e dorëzuar nga furnizuesi është një gabim i lëshuar nga furnizuesi i cili nuk ka dhënë çmimin për njësi por kjo është lehtësisht e kuptueshme nëse kemi sasinë dhe totalin e këtij pozicioni gjejmë edhe çmimin për njësi sepse ne kemi një ofertë me çmim më të ulët dhe kriter i DT dhe NJPK ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët ë ne kemi plotësuar këtë kriter. Ne nuk mund të kuptojmë se si ka mundësi që në kontratën që kemi me AK për "Mirëmbajtjen emergjente e rrugëve rurale llot II" me nr. të prokurimit 616 19 205 215 me çmime identike dhe nuk kemi asnjë problem në implementim dhe ne kemi sqaruar po ashtu AK se edhe këtë aktivitet të prokurimit do të implementojm në tërësi sikur atë të mirëmbajtjes emergjente, konsiderojmë se kemi të bëjmë me vlerësim jo real dhe jo të drejt në këtë rast. Ne po ashtu qëndrojmë në tërësi pranë ofertës sonë dhe nëse AK ka dyshime se nuk mund të implementojmë këtë kontratë kërkojmë që të ngitet sigurimi i ekzekutimit ashtu siç e parashev vetë autoriteti kontraktues. AK ka qenë i detyruar që të merr parasysh sqarimet tonë të dt.13.03.2020 sepse ne kemi dorëzuar edhe faturën e furnizuesit. Neni 61 i LPP e rregullon çështjen e çmimeve jo-normalisht të ulet sepse e paragrafi 2 i këtij neni e udhëzon AK që do të merr parasysh shpjegimet e dorëzuara nga tenderuesi.

1. Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkësë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni.

2. Gjatë përcaktimit nëse një tender është apo duket të jetë jo-normalisht i ulet, autoriteti kontraktues do të merr parasysh shpjegimet e dorëzuara nga tenderuesi në lidhje me:

- 2.1. ekonominë e procesit të prodhimtarisë, te shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;
- 2.2. çfarëdo zgjidhje teknike që janë Ofruar ose zgjedhur;
- 2.3. çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose
- 2.4. origjinalitetin, e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

Po ashtu AK nuk ka marr parasysh dispozitat e nenit 72 të LPP sepse pikërisht kjo dispozitë e obligon AK që në rastet e tilla ku vërehet qartë se kemi të bëjmë me një Ofertë me çmim më të ulët të kërkoj sqarime dhe ti vlerësoj drejt se a është një gabim teknik dhe ky gabim a mund të korrigohet apo kemi të bëjmë me një gabim të qëllimshëm nga ana e tenderuesi për të vënë në lajthitje AK”.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se pretendimet e larte cekura të operatorit ekonomik ankues nuk janë të bazuara sepse AK me rastin e rivlerësimit të ofertave konform nenit 72 të LPP-së, me datën 12.02.2020 përmes “letrës standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët” ka kërkuar sqarime shtesë nga grapi i OE ankues. Ndërsa, grapi i OE ankues me datën 13.02.2020 ka dorëzuar shkresën sqaruese së bashku me faturën nr.03/20 të datës 13.02.2020 të lëshuar nga “Lunari Company shpk” për “Bashkimi Meti shpk” në të cilin figuron “Furnizimi dhe transporti me rrëvë” me “çmim njësi prej 1 euro, si dhe Pro faturën nr.21/20 të datës 13.02.2020 të lëshuar nga “Besimi Commerce shpk” për “Bashkimi Meti shpk” në të cilin figuron “Kripë deti industriale (Refuz)” me çmim për njësi me tvsh prej 49 euro. Në bazë të faturës në të cilën ka figuruar çmimi prej 1 euro për rrëvë dhe konform rekomandimeve të dala nga vendimi i OSHP-së me numër PSH.nr.903/19 të dt.05.02.2020, AK ka zbatuar nenin 3.1 të “Rregullave për tenderët Jo-normalisht të Ulët”, në bazë të të cilave konstatohet se oferta e grupit të OE ankues për LOT 2, i plotëson të gjitha kushtet e mëposhtme të nenit 3.1 të “Rregullave për tenderët Jo-normalisht të Ulët”:

- çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;
- çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;
- janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

Po ashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se fakti i lartcekur, se oferta e grupit të OE ankues për LOT 2 është e papërgjegjshme dhe se i plotëson të gjitha kushtet e parapara me nenin 3.1 të “Rregullave për tenderët Jo-normalisht të Ulët” është konstatuar edhe me Vendimin e OSHP-së numër PSH.nr.903/19 të dt.05.02.2020, (fq. 14 të këtij vendimi).

Paneli Shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe sqarimet e ekspertit shqyrtues, vlerëson se autoriteti kontraktues ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve konform nenit 59 të LPP-së. Po

ashtu, Paneli Shqyrtues konsideron se autoriteti kontraktues ka vepruar konform dispozitave të LPP-së me rastin e kërkesës për sqarime lidhur me çmimet Jo-normalisht të Ulëta.


Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrues

Blerim DINA



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK Autoritetit Kontraktues – Kuvendi Komunal-Prishtinë..
- 1x1 OE ankues - “Afrim A Beka B.I. & Alkoimpex-general construction Sh.p.k.” (“Bashkimi Meti sh.p.k”)- Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb-faqe të OSHP-së.